URDHËR
Nr. 156, datë 21.6.2019

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM TË KOMPETENCAVE

Në zbatim të nenit 28 dhe nenit 29, të Kodit të Procedurave Administrative, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 58, datë 29.1.2004 "Për organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar", neni 26 i Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 1, datë 14.1.2015 "Për miratimin e rregullores së brendshme të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)", i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të mëposhtme të titullarit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, me përjashtim të kompetencave të cilat nuk delegohen dhe janë të shprehura me ligj, drejtorit të Drejtorisë së Financës Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, znj. Klarita Bejko.
2. Znj. Klarita Bejko ngarkohet me:
- ndjekjen dhe zbatimin e "Rregullores për funksionimin dhe organizimin e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar" (i ndryshuar);
- ndjekjen e detyrave të vendosura në planin mujor të muajit qershor 2019;
- merr dhe trajton korrespondencën shkresore urgjente;
- ndjekjen e detyrave të grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore.
3. Delegimin e përkohshëm të kompetencave të titullarit në funksion të Kontrollit të Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit, përgjegjësit të Sektorit për Kontrollin e Figurës së Subjekteve të Rivlerësimit z. Adhurim Hasanaj;
4. Z. Adhurim Hasanaj i delegohen kompetencat si më poshtë:
a) mbikëqyr dhe udhëzon Grupin e Punës për Kontrollin e Figurës së subjekteve të rivlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij;
b) përfaqëson Grupin e Punës në marrëdhëniet me:
- Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK);
- Kolegjin e Apelimit (KA) dhe Komisionerët Publikë;
- Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM);
c) organizon dhe drejton veprimtarinë e Grupit të Punës.
ç) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për realizimin e qëllimit, objektit dhe detyrave për të cilat është ngritur Grupi i Punës;
d) merr dhe trajton korrespondencën shkresore që lidhet me veprimtarinë e Grupit të Punës.
5. Kompetencat e mësipërme delegohen për periudhën 24.6.2019 deri më 27.6.2019.
6. Znj. Klarita Bejko dhe z. Hasanaj nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
7. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Financës Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore.
8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.
9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR
Dorian Tola